



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.147/2019**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevi kryesues, Afiete Sada-Gllogjani dhe Nenad Lazić anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkritazi me ankesën e BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosjes (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të përdorimit të personave në fushatë zgjedhore nën moshën 18 vjet, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 02.10.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**Hudhet e pasafatshme ankesa** e identifikuar me numër A.nr.147/2019 datë 30.09.2019, e paraqitur nga BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosjes (LVV), me seli në Prishtinë.

## A r s y e t i m

Me datën 30.09.2019, BIRN dhe IKS, kanë paraqitur ankesë në PZAP, me të cilën pretendojnë se me datë 27 Shtator 2019, në orën 07:16, në rrjetin social “facebook”, në profilin e kandidates për deputete Tinka Kurti, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, kanë vërejtur se ka shpërndarë një video, ku shihet një fëmijë. Me këtë rast ankuesi thekson se ky veprim është në kundërshtim me rregulloren e Nr. 20/2019 nenit 5 paragrafin 3 pika d). Në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi materiale ankuesi i ka bashkangjitur një CD, me propozim për panelin që të pranohet ankesa si e bazuar..

Paneli pas vlerësimit paraprak të afatshmëris së ankesës, gjeti se: **Ankesa është e pasafatshme**

Paneli pas shqyrtimit paraprak të ankesës, ka gjetur se e njëjta është paraqitur pas afatit ligjor të përcaktuar me nenit 5, paragrafi 5 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, ku përcaktohet: “Për të gjitha çështjet që nuk lidhen drejtpërdrejt me votimin dhe numërimin, ankesa duhet të parashtrëhet pranë PZAP-it, brenda 24 orëve nga shkelja e supozuar”. Në këtë rast ankesa është paraqitur në PZAP me datë 30.09.2019 në ora 18:16, ndërsa shkelja e

pretenduar supozohet se ka ndodhur me datë 27.09.2019 ne ora 18:30, nga kjo del se ankuesi ka paraqitur ankesë pas afati të përcaktuar me dispozitën e lartcekur.

Nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 115 paragrafi 1, neni 118 të LZP-së, lidhur me nenin 6 paragrafi 4 i Rregullave te Procedurave te PZAP-it, Nr. 02/2015.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**A.nr. 147/2019 me datë 02.10.2019**

**Kryesues i Panelit**  
**Adnan Konushevi**

